

RAPORTI VJETOR



HYRJE

OJQ ACDC Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike, është një organizatë joqeveritare, e themeluar dhe e regjistruar në vitin 2011, me seli në Mitrovicën e Veriut. ACDC promovon aktivizmin social, mobilizimin e qytetarëve në debate publike dhe promovimin e bashkëpunimit të qëndrueshëm ndërmjet pushtetit qendror, lokal dhe komunitetit në procesin e fuqizimit të sundimit të ligjit, demokracisë, transparencës së qeverisjes, bashkëpunimit ndëretnik, arsimit dhe punës me njerez te rinj.

Në vitin 2023, OJQ ACDC mbeti e palëkundur në përkushtimin e saj për të promovuar drejtësinë, të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit në Kosovë. Duke u mbështetur në themelet e hedhura në vitet e mëparshme, OJQ ACDC inicioi seminare të shumta, hulumtime, trajnime, fushata mediale dhe konferenca.

Gjatë vitit, OJQ ACDC organizoi më shumë se 10 konferenca dhe debate publike duke filluar nga çështjet thelbësore si: shpronësimi i tokës në veri të Kosovës deri te diskutimet mbi arsimimin e të rinjve, të drejtat e punës, diskriminimin, të drejtat e njeriut dhe bashkëpunimin ndëretnik. Përveç këtyre konferencave, ACDC publikoi analiza kërkimore mbi diskriminimin, situatën e drejtësisë në veri, të drejtat e punës dhe publikoi 20 tekste (OP-ED) dhe adresimin e të drejtave të njeriut dhe çështjeve sociale në Kosovë. Gjithashtu, u zhvilluan fushata të shumta që u fokusuan në promovimin e ndërgjegjësimit për rolin dhe mandatin e Avokatit të Popullit të Kosovës, duke avokuar për rëndësinë e Ndihmës Juridike Falas në Kosovë, ngritjen e vetëdijes për të drejtat e punës së grave dhe adresimin e çështjeve kritike të mbrojtjes së mjedisit dhe parandalimit të vërrshimeve.

Gjatë vitit 2023 janë realizuar gjithsej 17 projekte.

Projekti 1:

Mbështetje e mëtejshme për qasje në drejtësi dhe të drejtat e njeriut në rajonin e Mitrovicës

Periudha kohore: 19.08.2022. - 19.06.2023.

Financuar nga: UNMIK

Projekti kishte për qëllim fuqizimin e sistemit gjyqësor në rajonin e Mitrovicës duke rritur kapacitetin e përkthimit dhe interpretimit, përmirësimin e kushteve të punës në gjykata, trajnimin e avokatëve të rinj nga komunitetet joshumicë, ngritjen e kapaciteteve të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas dhe promovimin e rolit të Avokatit të Popullit.

Resultatet:

- Rritja e kapaciteteve për përkthyes/interpretues të Gjykatës Themelore të Mitrovicës, është rritur kapaciteti i Gjykatës për të zvogëluar numrin e lëndëve të pazgjidhura përmes ndihmës së bashkëpunëtorëve ligjor.
- Përmirësimi i kushteve të punës në Gjykatën Themelore të Mitrovicës, përmes mobilimit dhe pajisjeve
- Rritja e numrit të juristëve të rinj nga komunitetet joshumicë të trajnuar për të marrë provimin e jurisprudencës
- Rritja e kapaciteteve të Zyrës së Agjencisë Kosovare për Ndihmë Juridike Falas në Mitrovicën e Veriut
- Rritja e dukshmërisë së rolit dhe mandatit të Avokatit të Popullit.

Projekti 2:

Granti për Zhvillim Organizativ

Periudha Kohore: 01.09.2022. - 31.08.2023.

Ky grant mbështetet nga programi i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) 'EJA Kosovo', i bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) Suedi, dhe Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit ishte rritja e kapaciteteve të stafit të organizatës në mënyrë që të krijonte një drejtim të qartë të zhvillimit organizativ duke përdorur mjete dhe burime specifike që do të kontribuojnë në rritjen e organizatës, rritjen e nivelit të kapaciteteve, fuqizimin e menaxhimit të sistemit të brendshëm dhe të kontribuojnë në qasje më të mirë për përdoruesit e projektit.

Resultatet:

- Rritja e qëndrueshmërisë dhe funksionalitetit të organizatës duke përforcuar kapacitetet e organizatës.
- Është arritur menaxhimi efektiv i burimeve njerëzore dhe teknologjike.

Projekti 3:

Rritja e transparencës dhe sundimit të ligjit në komunitetet me shumicë serbe në Kosovë

Periudha Kohore: 30.09.2022. - 30.09.2023.

Financuar nga Byroja Ndërkombëtare e Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL).

Objekti i përgjithshëm i projektit ishte përmirësimi i administrimit të drejtësisë në veri të Kosovës dhe në zonat me shumicë serbe të Kosovës në rajonet e tjera të Kosovës, përmes mbështetjes për institucionet gjyqësore dhe lehtësimi të përfshirjes së avokatëve të rinj nga komunitetet joshumicë në praktikën juridike.

Projekti 4:

Avokimi për një pozitë më të mirë të grave shtatzëna dhe nënave të reja

Peridha kohore: 01.01.2023. - 30.06.2023.

Granti është financuar nga Bashkimi Evropian në Kosovë, në kuadër të projektit "Mbrotjtja dhe promovimi i të drejtave të punës të grupeve të cënueshme në tregun e punës", i zbatuar nga Qendra për Trajnime dhe Burime për Avokim - ATRC në partneritet me BIRN Kosovë.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit ishte të ofrojë mbështetje për gratë në Kosovë duke rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e mosdiskriminimit në fushën e ligjit të punës, si dhe duke identifikuar qëndrimin e qytetarëve, por në radhë të parë të grave, për të drejtat dhe detyrimet e punonjësve. Grupet e synuara ishin gratë e reja, gratë shtatzëna dhe nënat beqare që jetojnë në veri të Kosovës.

Resultatet:

- Është bërë matja e pozitës së grave të synuara dhe janë mbledhur rekomandimet;
- Ngritja e ndërgjegjësimit dhe njohurive të publikut mbi mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe të punës, përmes fushatës për komunikim publik.

Projekti 5:

Fuqizimi i ndërgjegjësimit mjedisor në veri të Kosovës

Periudha kohore: 01.03.2023 - 31.08.2023.

Projekti është zbatuar në kuadër të programit “Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore në Kosovë” (IWRM-K), i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Qeveria e Kosovës, dhe zbatohet nga Skat Consulting Ltd. (Zvicër) në konsorcium me Agjencinë e Mjedisit Austria (EAA).

Objekti kryesor i projektit ishte adresimi i sfidave të lidhura me ujin dhe trajtimi i problemeve ekzistuese dhe të mundshme në të ardhmen duke përdorur metodologjinë dhe qasjen e asistencës dhe ndërgjegjësimit. Kjo është arritur përmes rezultateve të matshme me miratimin dhe hartimin e politikave dhe planeve komunale për ruajtjen e puseve dhe lumenjve ekzistues.

Projekti 6:

Promovimi i të drejtave të njeriut dhe parimeve të mosdiskriminimit në nivel lokal

Periudha Kohore: 22.03.2023 - 10.06.2023.

Projekti është financuar nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë.

Objekti i përgjithshëm i projektit është ngritja e vetëdijes publike për (mos)diskriminimin dhe nxitjen e reagimit institucional ndaj diskriminimit përmes mobilizimit të të gjitha institucioneve kompetente dhe përmes trajnimit të fuqizimit të zyrtarëve komunal në Mitrovicën e Veriut.

Resultatat:

- Identifikimi i perceptimit publik për diskriminimin në Mitrovicën e Veriut.
- Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për diskriminimin dhe mekanizmat në dispozicion.
- Rritja e kapaciteteve të vetëqeverisjes lokale për parandalimin dhe reagimin ndaj diskriminimit.
- Krijimi i sinergjisë ndërmjet të gjitha palëve relevante të interesit në veri të Kosovës.

Projekti 7:

Platforma online për ndërtimin e shoqërisë së hapur dhe gjithëpërfshirëse në Kosovë

Periudha kohore: 28.03.2023 - 31.08.2023.

Mbështetur nga IOM dhe Ambasada Britanike në Kosovë

Objekti i përgjithshëm i projektit ishte të lehtësojë bashkëpunimin ndëretnik ndërmjet komuniteteve në Kosovë, përmes një platforme online të përshtatur për Zyrën për Çështje të Komuniteteve dhe mbështetjes për përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë.

Resultatet:

- Përfshirja e përfaqësuesit të komuniteteve joshumicë në mbledhjen e nevojave të çdo komuniteti të caktuar në Kosovë.
- Inkorporimi i nevojave dhe rekomandimeve në platformën online, duke i shërbyer çdo komuniteti në Kosovë.
- Ngritja e vetëdijes publike për rëndësinë e bashkëpunimit në vija etnike, punën e Zyrës për Çështje të Komuniteteve dhe platformën si mekanizëm në dispozicion për bashkëpunim dhe zgjidhje të çështjeve.
- Lehtësimi i bashkëpunimit të drejtuesve të komunitetit, duke i asistuar ata në formulimin e nevojave të tyre dhe bashkëpunimin me Zyrën për Çështje të Komuniteteve.

Projekti 8:

Promovimi i të drejtave dhe rolit të qytetarëve përmes reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë natyrore

Periudha kohore: 01.05.2023 - 01.11.2023.

Financuar nga: SMART Balkan

Qëllimi i përgjithshëm i projektit ishte ngritja e ndërgjegjësimit për rreziqet e fatkeqësive, ndryshimeve klimatike dhe promovimi i kohezionit social ndërmjet anëtarëve të komunitetit për të siguruar rezultate afatgjata dhe për të përmirësuar ndikimin në procesin e vendimmarrjes.

Resultatet:

- Hartimi i një strategjie lokale për parandalimin e vërrshimeve dhe reagimin adekuat në situata të caktuara.
- Forcimi i kohezionit social dhe qytetarëve të përfshirë në proceset vendimmarrëse nëpërmjet aktiviteteve të planifikuara në mënyrë specifike me të gjithë akterët e rëndësishëm lokal.
- Informimi i publikut për rreziqet nga përmytjet dhe ngritja e ndërgjegjësimit përmes një fushate mediale.

Projekti 9:

Përmirësimi i kapaciteteve të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas në veri të Kosovës

Periudha Kohore: 01. 05.2023 - 31.10.2023

Financuar nga: The Community Development Fund - CDF

Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti ishte ngritja e bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve joshumicë në veri të Kosovës dhe Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas dhe përmirësimi i kushteve për mbrojtësit e të drejtave të njeriut dhe ngritja e nivelit të cilësisë së ofrimit të shërbimeve nga Agjencia.

Resultatet:

- Puna e klinikës mobile të Ndihmës Juridike Falas u shtua me një avokat më shumë.
- Fushëveprimi dhe puna e klinikës mobile e Ndihmës Juridike Falas i prezantohet shumicës dërrmuese të popullsisë në lidhje me respektimin dhe ushtrimin e të drejtave të njeriut, mendimin kritik dhe qytetarinë aktive, si dhe vlerat universale të të drejtave të njeriut përmes fushatave të mediave sociale dhe ekspozimit të menduarit kritik përmes OP-ED-ëve.

Projekti 10:

Fuqizimi i perspektivës së të drejtave të njeriut nga pikëpamja joshumicë

Periudha kohore: 01.06.2023 - 30.11.2023

Projekti mbështetet nga Fondi për Zhvillimin e Komunitetit (CDF), përmes programit HumanRightivism, financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim – Sida.

Objekti i përgjithshëm i projektit ishte të fuqizojë të rinjtë nga radhët e komunitetit joshumicë në veri të Kosovës dhe të mbështesë pjesëmarrjen aktive të të gjithë anëtarëve të komunitetit të shkollave për të integruar vlerat dhe parimet e të drejtave të njeriut në të gjitha fushat e jetës arsimore dhe për të theksuar rëndësinë e edukimit për të drejtat e njeriut.

Resultatet:

- Qytetari aktive nga të gjitha komunitetet në veri të Kosovës që inkurajohen dhe mbështeten në zhvillimin e një kulture globale të të drejtave të njeriut duke edukuar dhe fuqizuar të rinjtë, mësuesit dhe komunitetin e gjerë shkollor për të krijuar vlera të të drejtave të njeriut më të vlerësuara në Kosovë.

- Promovimi i mirëkuptimit, respektimit dhe gëzimit të të drejtave të njeriut, mendimi kritik dhe qytetarisë aktive, si dhe vlerat universale të të drejtave të njeriut përmes fushatës avokuese #humanrightschampions dhe mendimit kritik të ekspozuar përmes OP-ED-ëve.

Projekti 11:

Promovimi i dialogut ndëretnik në pushtetin lokal 2023

Periudha kohore: 01.02.2023 - 31.01.2024

Projekti është financuar nga National Endowment for Democracy (NED)

Përmes anketave, fokus grupeve dhe raportimit gjithëpërfshirës, projekti synoi të kuptojë perspektivat e komunitetit dhe të zhvillojë plane lokale të veprimit për të fuqizuar Komitetin për Komunitete në Zvečan. Nisma përfshinte lehtësimin e takimeve të mëtejshme të komunitetit, organizimin e konferencave publike dhe promovimin e ndërgjegjësimit për të nxitur bashkëpunimin dhe ndërtimin e lidhjeve më të forta ndërmjet komuniteteve të ndryshme në rajon.

Projekti 12:

Rritja e punësimit të komunitetit serb dhe boshnjak

Periudha kohore: 01.08.2023 - 31.05.2024

Ky projekt synon të prezantojë qasje inovative për rritjen e punësueshmërisë së pjesëtarëve të komunitetit serb dhe boshnjak. Fokusi qëndron në bashkëpunimin e ngushtë me institucionet kosovare, përkatësisht Agjencinë Kosovare të Punësimit për të kontaktuar komunitetin serb dhe boshnjak dhe ofrimin e trajnimeve.

Objekti i përgjithshëm është të kontribuojë në zhvillimin ekonomik dhe në rritjen e punësimit në tregun e punës në veri të Kosovës përmes fuqizimit të të rinjve. Kjo objektivë do të arrihet përmes fuqizimit të të rinjve për të qenë më konkurrues në tregun e punës. Të rinjtë 'NEET' nga komuniteti serb dhe boshnjak do të kontaktohen në bashkëpunim me agjencitë e punësimit të Mitrovicës së Veriut.

Ky projekt mbështetet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), Republika Federale e Gjermanisë.

Projekti 13:

Mbështetja e qasjes në drejtësi në veri të Kosovës

Periudha kohore: 24.08.2023. - 24.06.2024.

Ky projekt synon të sigurojë mbështetje të mëtutjeshme për gjyqësorin e integruar në veri të Kosovës me vazhdimin e shërbimeve nga përkthyesit/interpretuesit dhe katër bashkëpunëtorët ligjorë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dhe të plotësojë boshllëkun derisa të punësohen përkthyes dhe bashkëpunëtorë ligjorë shtesë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK).

Përveç mbështetjes për gjyqësorin e integruar, projekti do të avancojë konsolidimin e sundimit të ligjit në veri të Kosovës duke rritur kapacitetet lokale për Ndihmë Juridike Falas dhe duke mbështetur avokatët e rinj nga komunitetet joshumicë për t'u përgatitur për provimin e jurisprondencës në Kosovë.

Për më tepër, projekti synon të angazhojë komunitetet lokale në veri të Kosovës përmes dialogut për të ardhmen e integruar të gjyqësorit përmes konferencave dhe takimeve të komunës. Gjithashtu synon të mbledh njohuri të sakta mbi funksionimin e gjyqësorit të integruar dhe perceptimin publik.

Projekti 14:

M4Y Komunitat për të rinj - Fuqizimi i të rinjve për ndryshim

Periudha kohore: 01.09.2023 - 30.06.2024.

Financimi i Projektit dhe Partnerët; I gjithë programi mbështetet nga Qeveria e Japonisë përmes Fondit Japonez për Zhvillim Social, dhe me përfshirjen e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal të Qeverisë së Kosovës, së bashku me Fondin për Zhvillim të Komunitetit (CDF).

- Misioni i projektit është të fuqizojë individët e rinj të moshës 15 deri në 24 vjeç në Kosovë duke nxitur pjesëmarrjen e tyre aktive në zhvillimin e komunitetit.
- Iniciativat Rinore: Së bashku me 15 komuna, do të mbështeten projekte të drejtuara nga të rinjtë që trajtojnë çështjet lokale.
- Ndikimi në Komunitet: Qëllimi ynë është të përfundojmë me sukses 100 projekte komunitare, të gjitha të fuqizuara nga pasioni dhe përkushtimi i të rinjve kosovarë.

Komunitat e synuara; Për vazhdimin e projektit M4Y janë shtuar më shumë komuna. ACDC do të jetë përgjegjëse për këto komuna: Ranillug, Skenderaj, Vushtrri, Graçanicë dhe Fushë Kosovë.

Projekti 15:

Qasja në drejtësi për të gjithë: Përmirësimi i qasjes për ndihmë juridike falas në veri të Kosovës

Periudha kohore: 15.09.2023 - 15.03.2024

Mbështetur nga Ministria për Komunitete dhe Kthim.

Projekti synon ngritjen e kapaciteteve dhe promovimin e mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve në veri të Kosovës. Përmes aktiviteteve dhe iniciativave të ndryshme, projekti synon të përmirësojë bashkëpunimin ndërmjet komuniteteve pakicë në veri të Kosovës dhe institucioneve përkatëse, me fokus të veçantë në ofrimin e ndihmës juridike falas si mekanizëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Projekti fokusohet në rritjen e ndërgjegjësisimit për të drejtat e njeriut përmes fushatave të mediave sociale dhe artikujve të autorizuar që do të eksplorojnë dhe trajtojnë çështje thelbësore për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve. Theksi do të vihet në përfshirjen e grave dhe të rinjve në iniciativat që synojnë informimin dhe angazhimin e qytetarëve në kuptimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Projekti 16:

Avancimi i të drejtave të njeriut nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësisimit të publikut

Periudha kohore: 30.09.2023. - 30.06.2024

Financuar nga UNMIK

Projekti është krijuar për t'iu përgjigjur situatës aktuale të të drejtave të njeriut ndërmjet pretendimeve të përsëritura për shkelje të të drejtave të njeriut në veri të Kosovës dhe hendekut të vazhdueshëm në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Përmes bashkëpunimit të zgjeruar, qasshmërisë dhe ndërgjegjësisimit, projekti synon të fuqizojë banorët, të forcojë besimin në institucione dhe të promovojë mekanizma efektiv për adresimin e sfidave të të drejtave të njeriut në veri të Kosovës.

Projekti do të synojë të arrijë rezultatet e mëposhtme: një forum të fuqizuar të bashkëpunimit ndërmjet Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës (IAPK) dhe Shoqërisë Civile; një formular ankese në internet që funksionon në faqen e internetit të IAPK-së; rritja e ndërgjegjësisimit për të drejtat e njeriut dhe mekanizmat e dëmshpërblimit; një model i zhvilluar i stilit të raportimit për IAPK bazuar në treguesit e të drejtave të njeriut; rritja e monitorimit, raportimit dhe ndërgjegjësisimit të shtuar për gjendjen e të drejtave të njeriut.

Projekti 17:

Rritja e transparencës dhe sundimit të ligjit në komunitetet me shumicë serbe në Kosovë

Periudha Kohore: 15.11.2023 - 15.11.2024

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të përmirësojë administrimin e drejtësisë në veri të Kosovës dhe në zonat me shumicë serbe të Kosovës në mbarë Kosovën duke rritur efikasitetin e institucioneve të integruara gjyqësore, duke lehtësuar përfshirjen e avokatëve të rinj nga komunitetet joshumicë në profesionin ligjor, dhe ndërgjegjësimin e publikut për funksionimin e këtyre institucioneve dhe të drejtat e qytetarëve.

Objektivat:

- Objektivi specifik 1: Rritja e efikasitetit të institucioneve të integruara gjyqësore në veri të Kosovës dhe në zonat tjera me shumicë serbe në Kosovë.
- Objektivi specifik 2: Të kontribuojë në përfshirjen më të mirë të avokatëve të rinj në praktikën juridike nga komunitetet joshumicë në Kosovë.
- Objektivi specifik 3: Ngritja e vetëdijes publike për funksionimin e institucioneve të integruara gjyqësore në veri të Kosovës dhe në zonat me shumicë serbe të Kosovës dhe të drejtat e qytetarëve para këtyre institucioneve.

